

VENDIM

Nr. 1066, datë 23.12.2015

PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK "PËR PAJISJET DHE SISTEMET MBROJTËSE PËR PËRDORIM NË AMBIENTE (ATMOSFERË) POTENCIALISHT SHPËRTHYESE"³ DHE PËRCAKTIMIN E LISTËS SË STANDARDEVE TË HARMONIZUARA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, pika 17, 5, pika 2, 6 dhe 42, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullit teknik "Për pajisjet dhe sistemet mbrojtëse për përdorim në ambiente (atmosferë) potencialisht shpërthyes", sipas tekstit bashkëlidhur, që është pjesë e këtij vendimi.
2. Përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara shqiptare, me karakter referues për prezumimin e konformitetit të pajisjeve dhe sistemeve mbrojtëse, të parashikuara për përdorim në atmosferë potencialisht shpërthyes, sipas listës bashkëlidhur, që është pjesë e këtij vendimi.
3. Standardet e harmonizuara shqiptare, numrat dhe titujt e të cilëve janë përfshirë në listën e përmendur në pikën 2, të këtij vendimi, shërbejnë si dokumente reference për prezumimin e konformitetit të pajisjeve dhe sistemeve mbrojtëse, të parashikuara për përdorim në atmosferë potencialisht shpërthyes, me kërkesat thelbësore të sigurisë, të përcaktuara në rregullin teknik të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e zbatimit të tij nga data 1.1.2016.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

³ Direktiva e Parlamentit dhe Këshillit Evropian 94/9/EC, e datës 23 mars 1994, "Për përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me pajisjet dhe sistemet mbrojtëse për përdorim në ambiente (atmosferë) potencialisht shpërthyes", numri celex 31994L0009;

Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 100, datë 19.4.1994, faqe 1-29.

Faqe|15288

Copyright 2020 - www.ligjet.org